



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË
AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR PËR
VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	6
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	9
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	11
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	14
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit.....	15

Për: z. Bahri Nuredini, Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Adresa: Vrellë, Lipjan, 10070,

1 Opinioni i auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet¹.

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit *‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’*. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

Konkluzioni i auditimit për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të ASHNA-së me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimit të çështjes të përshkruar në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit ASHNA-së kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se entiteti nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

- ASHNA kishte paguar me vonesë 16 pagesa në vlerë 424,619€ si dhe nuk kishte raportuar një pjesë të faturës në vlerë prej 20,000€.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ASHNA.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të

³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur fusha për përmirësim përfshirë kontrollin e brendshëm në regjistrimin e pasurive kapitale, vonesave në pagesa dhe raportimin e detyrimeve, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. (Për detaje shih kapitullin 4)

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesë në pagesë dhe dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas rregullores financiare neni 37.1 Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë. Kurse sipas Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore të nenit 17, pika 3 kërkohet që Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

ASHNA kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo gjatë auditimit kemi vërejtur si në vijim:

- Në 16 pagesa në vlerë 424,619€ kishte vonesë në pagesë nga 18 deri 294 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh; dhe
- Pas pagesës së një fature në vlerë 37,927€, pjesa e mbetur e faturës së papaguar në vlerë 20,000€ nuk ishte raportuar në raportin e obligimeve të papaguara në PFV.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe punës me staf esencial.

Ndikimi Mos raportimi i obligimeve mujore ndikon në raportimin jo të drejtë, ndërsa vonesa në pagesën e obligimeve rrit rrezikun për shpenzime shtesë gjyqësore apo të përmbarimit.

Rekomandimi B1 Drejtori duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj si dhe të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokatipale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 5,485,621€, pasurive jokatipale është 46,452€, si dhe e stoqeve 11,179€. Kemi testuar 7 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 708,694€.

Çështja B2 – Mos regjistrim i pasurive në regjistrat kontabël

Gjetja Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rreg. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Gjatë testimeve kemi vërejtur që ASHNA nuk kishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale mbi 1,000€ pasuritë në vlerë 85,812€ si në vijim:

- Pagesën për projektin supply installation of radiocommunications system në germi në vlerë 46,174€, pjesë e pagesës nga fatura 429,032€;
- Pagesën për projektin APP/TWR në vlerë 37,927€; dhe
- Një TV LED 75 Ultra HD në vlerë 1,711€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i pagesave në fund të vitit dhe kontrollit jo të duhur që pagesat e blerjes së pasurive të regjistrohen në regjistrat përkatës, si dhe për shkak të mos pageses së faturave si rezultat i rënies së të hyrave që ndërlidhet me ndalimin e fluturimeve prej të cilave ASHNA gjeneron të hyra.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV-të e ASHNA-së duke i nënvlerësuar ato.

Rekomandimi B2 Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2020 Shpenzimi	2019 Shpenzimi	2018 Shpenzimi
Burimet e fondeve	8,092,593	8,145,900	5,425,954	6,295,234	3,729,812
Grante Qeveritare – Buxheti	2,392,726	2,446,033	2,202,644	1,442,737	423,016
Te hyrat e dedikuara	5,699,867	5,699,867	3,223,310	4,458,847	3,306,796
Te hyrat nga AKP-ja	-	-	-	393,650	-

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 53,307€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë.


Në vitin 2020 OB ka shpenzuar 67% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 5,425,954€, me një ulje prej 16% në krahasim me vitin 2019. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimi	2019 Shpenzimi	2018 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	8,092,593	8,145,900	5,425,954	6,295,234	3,729,812
Pagat dhe mëditjet	2,838,816	3,079,509	2,756,812	2,757,216	2,543,064
Mallrat dhe shërbimet	1,418,857	1,653,476	772,286	1,391,945	669,249
Komunalitë	102,370	119,454	54,272	98,721	94,483
Investimet kapitale	3,732,550	3,293,461	1,842,583	2,047,352	423,016

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike



Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë e buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final te kategoria e pagave dhe meditjeve në raport me atë fillestar kishte rritje për 240,693€, e cila ishte bërë me vendimin e Qeverisë. Ne këtë kategori shpenzimi i buxhetit ishte 90%;
- Te kategoria e Mallra dhe Shërbime buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 234,619€ me vendim të qeverisë. Shpenzimi ishte 47% e buxhetit, për arsye të reduktimit të shpenzimeve si rezultat i pandemisë;
- Po ashtu me vendim të qeverisë ishte rritur edhe buxheti final te komunalitë për vlerën 17,084€. Shpenzimi në këtë kategori ishte 45%; dhe

- Për dallim nga kategoritë tjera, buxheti final te Investimet kapitale ishte zvogëluar në raport me atë fillestar për 439,090€. Së pari, me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 843,704€, pastaj me vendim të qeverisë ishte rritur prapë për vlerën 404,615€. Shpenzimet ishin 56% e buxhetit.

Të hyrat e realizuara nga ASHNA në 2020 ishin në vlerë 2,472,980€. Ato kanë të bëjnë me shërbimet terminale apo dhënies së shërbimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Të hyrat e dedikuara	-	-	2,472,980	4,518,808	4,001,872
Totali	-	-	2,472,980	4,518,808	4,001,872

ASHNA realizon të hyra të dedikuara duke ofruar shërbime të navigacionit ajror ndaj Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të ASHNA ka rezultuar në katër rekomandime kryesore. ASHNA kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, dy rekomandime janë zbatuar ndërsa dy nuk ka filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 3, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori duhet të siguroj që për të gjitha shpenzimet janë bërë planifikimet e duhura me kohë, në mënyrë që shpenzimi i tyre dhe regjistrimi të jetë në kategoritë e duhura ekonomike.	Menaxhmenti ka ndërmarr masa dhe nuk kemi raste të tilla në vitin 2020.	I zbatuar.
2	Investime kapitale	Drejtori të siguroj që furnizimet e kontraktuara bëhen brenda afateve të kontratës duke siguruar paraprakisht që procedurat apo hapat e zotimit dhe urdhër blerjes janë bërë me kohë.	Në vitin 2020 nuk kemi pasur raste të tilla. Vlen të theksohet që si rezultat i pandemisë, këto raste kanë qenë të arsyeshme.	I zbatuar.
3	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Edhe këtë vit kemi pasuri kapitale të cilat nuk janë regjistruar.	Nuk ka filluar zbatimin.
4	Detyrimet e papaguar a	Drejtori duhet të siguroj kontrole në raportimin e obligimeve mujore, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudhat kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj deri sa të paguhen.	Edhe këtë vit kemi vonesa të theksuara në pagesa dhe dobësi në raportimin e tyre.	Nuk ka filluar zbatimin.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.		
2	Detyrimet e papaguar a	Drejtori duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj si dhe të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.		

Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit



Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror


Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit



Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Bahri Nuredini

Drejtor – Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Data: 31.05.2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

⁵ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

⁶ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,

nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.